



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1105/2 prot.,

Datë 07.05.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Infini*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar - Pune*”, me REF-00575-04-08-2024, me objekt “*Mirembajtje Kanali Ujites Leshnice*”, me fond limit 2,260,800 (dy milion e dyqind e gjashtëdhjete mijë e tetëqind) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 22.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike Pogradec.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Infini*” SHPK me NIPT J74304623M, me adresa: Rruga “Fan Noli”, Lagjja Nr. 3, nr pasurie 3/167, Pogradec.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike Pogradec.
Adresa: Lagja nr 2, bulevardi “Reshit Çollaku”, Pogradec.

Në datë 03.05.2024 nwpwrmjetw sistemit tw ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është depozituar ankesa elektronike me numër A/2024/4051, dhe me nr. 1105/2024 Prot., date 07.05.2024 e operatorit ekonomik “*Infini*” dshh, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar - Pune*”, me REF-00575-04-08-2024, me objekt “*Mirembajtje Kanali Ujites Leshnice*”, me fond limit 2,260,800 (dy milion e dyqind e gjashtëdhjete mijë e tetëqind) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 22.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike Pogradec.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Infini*” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose

enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.

- I plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.

- Nuk plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1.Operatori ekonomik “Infinit” shpk nuk ka deklaruar disponimin e 1 Tekniku Ndertimi të kerkuar në pikën 2.3.4 të kriterëve të kapacitetit teknik.

2.Per të deshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3, operatori ekonomik ofertues “Infinit” shpk është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk.

Fusha e ekspertizës që i takon inxhinierit hidroteknik, si drejtues Teknik i pranishëm në licencën e shoqërisë do të përmbushet 100% nga inxhinieri i paraqitur me mbështetje në kapacitetet e “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, duke mos ju përmbajtur nën 90 pika 2/4 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar e cila përcakton që minimum 50% të kriterit OE ofertues e përmbush vete: “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kerkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE “Infinit” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 07.05.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini